

RAPORTI VJETOR

2018





PËRMBAJTJA

I. MESAZHI I DREJTORIT.....	5
II. KORNIZA REGULLATORE.....	7
II.1. Legjislacioni doganor.....	7
II.2. Akcizat.....	7
III. PROCESI I ADERIMIT DREJT BASHKIMIT EVROPIAN.....	9
III.1. Harmonizimi me legjislacionin evropian dhe zhvillimi i kapacitetit administrativ duke u mbështetur në standardet e Bashkimit Evropian.....	9
IV. RESURSET NJERËZORE NË DREJTORINË E DOGANAVE.....	12
IV.1. Trajnime dhe përsosje profesionale.....	14
IV.2. Lëndët e trajnimeve që rregullisht janë mbajtur gjatë vitit 2018.....	14
IV.3. Të mësuarit elektronik.....	15
IV.4. Integriteti.....	16
V. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I PROCEDURAVE DOGANORE.....	18
V.1. Kushtet për zbatimin e formaliteteve doganore	18
V.2. E-Dogana.....	19
V.2.1. Sistemi për përpunimin e deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës (SPDDDA).....	19
V.2.2. EXIM.....	23
V.2.3. Deklarata doganore të përpunuara.....	23
V.3. Operatori i autorizuar ekonomik.....	24
VI.TËHYRATËPAGUARA –	27

VII. KONTROLLI DHE ZBATIMI I LIGJEVE.....	28
VII.1. Kontrolli doganor dhe kontrollat tjera	28
VII.2. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale	37
VII.3. Laboratori doganor	37
VII.4. Padi penale.....	38
VII.5. Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare.....	39
VIII. TRANSPARENÇË DHE BASHKËPUNIM NË FUSHËN DOGANORE	39
VIII.1. Marrëdhënie me publikun.....	39
VIII.1.1. Ngjarje më të spikatura.....	40
VIII.1.2.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar	42
VIII.2.2. Takime bilaterale	43
VIII.3.2. Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit.....	46
VIII.3.3. Promovim i konceptit Operator i autorizuar ekonomik	47
VIII.3.4 Memorandume të nënshkruara për bashkëpunim.....	48
VIII.4. Internet	49
VIII.5. Linja e hapur telefonike e doganës (197).....	49

VIZIONI

TË BËHEMI DREJTORI E DOGANAVE LIDER NË RAJON, QË DO TË MUNDËSOJ MBËSHTETJE TË FUQISHME NË EKONOMINË LEGALE DHE HARMONIZIM TË PLOTË ME STANDARDET E BASHKIMIT EVROPIAN.

MISIONI

TË MBROJMË INTERESAT FINANCIARE DHE SHOQËRORE, NJËKOHËSISHT DUKE MBËSHTETUR ZHVILLIMIN EKONOMIK PËRMES BASHKËPUNIMIT, LEHTËSIMIT DHE MODERNIZIMIT

I.MESAZHI I DREJTOIT



Të nderuar ,

Drejt vizionit të cilin e kemi vendosur para vetes sonë – që të jemi Drejtori e doganave lider në rajon sipas standardeve më të larta evropiane, dhe njëkohësisht të denjë në mbrojtjen e interesave financiare dhe shoqërisë, edhe vitin e kaluar kemi vazhduar me një ritëm të përshpejtuar në drejtim të integritimit të plotë në Bashkimin Evropian, duke mbështetur zhvillimin ekonomik përmes bashkëpunimit, lehtësimit dhe modernizimit.

Vazhdojmë me harmonizimin e legjislacionit doganor me atë të BE-së. Prioritetet tona vitin e kaluar ishin aktivitetet lidhur me lehtësimin e tregtisë, sigurimin e procedurave doganore të thjeshtuara për operatorët ekonomik dhe përfshirja e statusit Operator i autorizuar ekonomik - koncept që bazohet në partneritet mes Doganës dhe komunitetit të biznesit.

Jemi krenar që përmes një game të gjerë trajnimesh dhe seminaresh për njohje me markën e njohur ndërkombëtarisht cilësi, mundësuam që komuniteti i biznesit të njeh përfitimin nga ky koncept. Rrjedhimisht gjatë vitit 2018 dy kompani veç më fituan statusin Operator i autorizuar ekonomik, ndërsa për disa të tjerë procedura është në rrjedhë e sipër. Si indikator i besimit të rritur, është sjellë dhe filloi zbatimi i ndryshimit ligjor për reduktimin e gjobave për kundërvajtjet për 50%. Në konsultë me komunitetin e biznesit kemi hartuar një propozim për një ligj të ri të akcizave, që është harmonizuar me legjislacionin evropian dhe pritet të hyj në fuqi në gjysmën e dytë të vitit 2019.

Janë realizuar disa projekte madhore të financuara nga IPA fondet e BE-së. Në shtator të vitit 2018 paralajmëruam fillimin e Projektit për menaxhim të përbashkët kufitar (One Stop Shop) të pikës së modernizuar të kalimit kufitar Tabanoc me Republikën e Serbisë, me të cilin Korridori 10 do të jetë më atraktiv dhe më efikas për eksport, import dhe transit të mallrave. Në pikën e kalimit kufitar Qafëthanë janë ndërtuar objekte për zhdoganim dhe zbatim të kontrolleve të inspektimit, si dhe një terminal i ri dhe rrugë më të qasshme. Në drejtim të përforsimit të kapaciteteve për kontroll gjatë zhdoganimit, laboratorit doganor fitoi pajisje të reja, moderne dhe më të sofistikuar. Vitin e kaluar Drejtorja e doganave ia doli që të ndërroj një faqe të re në punën e saj – është finalizuar zhvillimi i Sistemit për përpunim të deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës (SPDDDA) që do të zëvendësoj sistemin e deritanishëm ASIKUDA. Rrjedhimisht, të gjitha procedurat që deri më tani janë realizuar në letër do të zëvendësohen me procedura elektronike. Me implementimin e sistemit të ri që paraqet një parakusht për zhvillim të mëtejshëm të zgjidhjeve dhe shërbimeve digjitale, dukshëm do të thjeshtohet puna e nëpunësve doganor, agjencive kufitare dhe e të gjithë pjesëmarrësve në procedura të jashtme – tregtare doganore si dhe do të krijohet një rrethinë doganore më efikase dhe më moderne në pajtueshmëri me zhvillimin global dhe erën digjitale. Sistemi i ri do të funksionoj në një tërësi të integruar me sistemet ekzistuese dhe bazohet në ndërlidhshmëri dhe ndërveprim me sistemet e BE-së që na presin në të ardhmen. Gjithashtu dua të potencoj diçka që nuk është aspak e parëndësishme se kemi vendosur dhe do të vazhdojmë të zbatojmë standarde të larta të integritetit në drejtim të efektivitetit, efikasitetit dhe besueshmërisë së të punësuarve, dhe jemi kyçur në trendin botëror të të mësuarit gjatë gjithë jetës me mbajtjen e trajnimeve profesionale. Në faqen tonë të internetit kohëve të fundit mund të gjenden kurse për të mësuarit elektronik nga Organizata botërore e doganave.

Me kënaqësi dhe krenari mund të vij në përfundim se vitin që e lamë pas kemi arritur një përparim të madh dhe e kemi modernizuar Drejtorinë tonë të doganave. Falënderim dhe mirënjohje u shpreh të gjithë të punësuarve për profesionalizmin, përkushtimin dhe entuziazmin e tyre gjatë realizimit të objektivave të vëna, ndërsa rezultatet e arritura do të jenë motivim për një punë të mëtejshme me vlerë dhe arritje dhe suksese edhe më të mëdha në të ardhmen.

Ju faleminderit,

m-r Gjoko Tanasoski

Drejtor

II. KORRNIZA REGULATORE

II.1. Legjislacioni doganor

Duke pasur për qëllim thjeshtimin e procedurave doganore, reduktimin e shpenzimeve të operatorëve ekonomik dhe përforcimin e ekonomisë së vendit, gjatë vitit 2018 Drejtoria e doganave intensivisht ka zbatuar aktivitete në drejtim të përmirësimit të legjislacionit doganor si më poshtë:

JANË SJELLË BAZA LIGJORE PËR KONCEPTIN E OPERATORIT TË AUTORIZUAR EKONOMIK

Ligji për ratifikim të protokollit shtesë 5 të Marrëveshjes për CEFTA

Me këtë Protokoll është paraparë njohje e ndërsjellë e operatorëve të autorizuar ekonomik të vendit me çdo palë CEFTA, që dukshëm përmirëson qarkullimin e mallrave dhe shkëmbimit tregtar në rajon, me tregje të vendeve të treta, dhe në veçanti me tregjet e Bashkimit Evropian.

Ligji doganor dhe Rregullorja për zbatimin e Ligjit doganor në pjesën e OAE është harmonizuar me legjislacionin evropian. Konstatohen kriteret e përafërta për fitimin e statusit OAE, privilegjet e kompanive dhe mënyra e aprovimit dhe lëshimit të aprovimit.

GJOBA TË REDUKTUARA PËR KUNDËRVAJTJE

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Drejtorinë e doganave dhe Ligjit doganor, të sjellë në gusht 2018, numri më i madh i kundërvajtjeve doganore, lroi parimin e deritanishëm për shqiptim të gjobave me urdhër pagese të mandatit dhe hyri në fuqi lëshimi i urdhër pagesës për kundërvajtje.

- ♣ Gjobat janë reduktuar për **50%**
- ♣ Mundësia për pjesëmarrje aktive në procedurë para Komisionit që vendos sipas kundërvajtjeve, mbrojtja e mëtejme ligjore para Komisionit shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në fushën e mbikëqyrjes së inspektimit dhe procedurës së kundërvajtjes, si dhe mbrojtje ligjore para gjykatave administrative.

II.2. Akciza

Është hartuar një Ligj i ri për akcizat i harmonizuar me legjislacionin e akcizave të BE-së, që pritet të hyj në fuqi në gjysmën e dytë të vitit 2019.

Gjatë hartimit të Ligjit, janë marrë parasysh shqyrtimet dhe mendimet e komunitetit të biznesit:

- Prodhuesve dhe importuesve të duhanit,
- Sektorit energjetik, si dhe
- Prodhuesve bujqësor dhe
- Prodhuesve me pakicë të birës dhe pijeve alkoolike.



III. PROCESI I ADERIMIT DREJT BASHKIMIT EVROPIAN



Vendet anëtare të Bashkimit Evropian janë pjesë e Bashkimit doganor dhe ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Kjo kërkon harmonizim me legjislacionin, kapacitetet përkatës për zbatim, qasje deri tek sistemet e kompjuterizuara doganore.

III.1. Harmonizim i legjislacionit evropian dhe zhvillim i kapacitetit administrativ duke u mbështetur në standardet e Bashkimit Evropian.

IPA PROJEKTE

Rindërtim i objekteve për zhdoganim dhe organeve të inspektimit në pikën e kalimit kufitar Qafëthanë (IPA 2013)

- Ndërtim i objekteve për zhoganim dhe organe të inspektimit;
- Terminal i ri doganor prej 9,5 mijë m²;
- Rrugë të qasshme;

Përforcim i kapaciteteve operative dhe institucionale të Drejtorisë së doganave (IPA 2013)

- Harmonizim i mëtejshëm i legjislacionit nacional doganor me legjislacionin e BE-së;
- Rritje e efikasitetit gjatë zbulimit dhe pengimit të mashtrimeve doganore përmes kontrolleve më efikase dhe me qëllim;
- Përforcim i kapaciteteve pas zhdoganimit dhe zbatimit të metodave laboratorike dhe mjeteve bashkëkohore ;
- Lehtësim i tregtisë përmes përsosjes së analizës së rrezikut duke u mbështetur në praktikat e mirëfillta dhe standardet e BE-së;
- Pajisje të reja për laboratorin doganor.

Projekti është në rrjedhë dhe pritet që të përfundoj deri në fund të vitit 2019.

Projekte të planifikuara

Programi për reforma të menaxhimit me financa IPA 2

- Përmirësim i cilësisë së procedurave doganore – Twinning projekt;
- Përmirësim i cilësisë së kontrolleve doganore dhe luftës kundër mashtrimeve dhe kontrollit të palejuar me mall;
- Prokurim i pajisjeve të sofistikuar;
- Krijimi i një Qendre për rimëkëmbje nga katastrofat
- Prokurim i TIK pajisjeve;
- Sistem i ri për kontroll dhe hetime dhe Depo e re e të dhënave (Data Warehouse)

Projekte të planifikuara të sistemeve TIK për implementimin e ndërlidhjes dhe ndërprobabilitetit me sistemet e BE-së

- Përmirësim i NCTS sistemit;
- Përgatitje e Sistemit për regjistrim dhe identifikim të operatorëve ekonomik EORI;
- Përgatitje e Sistemit të automatizuar të eksportit SAK;

Projekte të planifikuara me financa nga huazimet e Bankës botërore

- Përgatitje e një sistemit të ri nacional Single Window Sistem (NSW)
- Sistem i ri për video vëzhgim
- Përmirësim infrastrukturor i vendkalimeve kufitare;

PROGRAMI DOGANA 2020 – Program i Komisionit Evropian

53 nëpunës kanë marrë pjesë në 29 evente (trajtime, seminarë, mbledhje pune)

- Në kuadër të Programit të Bashkësisë DOGANA 2020 gjatë vitit 2018, nëpunësit doganor në mënyrë të vazhdueshme kanë marrë pjesë në aktivitete të shumta në drejtim të përforcimit të kapacitetit administrativ dhe operativ të Drejtorisë së doganave, përmes ekspertizës, njohurive dhe përvojave me vendet evropiane.
- Përmes programit DOGANA 2020 ka vazduar zbatimin nyjes së komunikimit (CCN/CSI) themeluar për nevojat e lidhjes së sistemeve evropiane.

SISTEMI PËRBASHKËT I TRANSITIT I VENDEVE TË BE-së DHE EFTA

Nga 1 janari 2019 Republika e Maqedonisë së Veriut kryeson me Komitetin e përbashkët për Konventën e transitit të përbashkët

- Konventat për procedurë të përbashkët transiti dhe thjeshtësim të formaliteteve gjatë tregtisë së mallit sigurojnë një lëvizje të vetme të mallit brenda kufijve të vendeve anëtare, nga një pikë hyrëse deri te vendi i përfundimit të procedurës së transitit.
- Deklarata elektronike e transitit me të cilën ka filluar procedura e transitit është e pranueshme për të gjitha vendet anëtare të Konventës për procedurë të përbashkët transiti.

Janë përpunuar 84.659 deklarata doganore në procedurë të përbashkët transiti (BE dhe EFTA)

Janë pranuar gjithsej 33.950 lëvizje transiti ku zyrat tona doganore kanë qenë zyra të destinacionit


Kanë transituar gjithsej 45.281 lëvizje transiti ku zyrat tona doganore kanë qenë zyra transiti;

IV. REZURSET NJERËZORE NË DREJTORINË E DOGANAVE




Aderimi strategjik në zhvillimin e resurseve njerëzore në Drejtorinë e Doganave është zhvilluar ndaj parimit menaxhim me kompetenca, që duhet të jenë të ndara, njohura, certifikukara dhe gjithnjë të inkorporuara dhe mbajtura në një nivel të lartë të avancimit. Kërkesat për profesionalizëm ndërrohen dhe tentojnë në rregullimin dhe modernizim pa ndalesa, që në mënyrë të drejtpërdrejtë mes tjerave edhe nga ndryshimet ligjore, përfshirja e punës elektronike doganore dhe nevojat e zgjeruara bashkëkohore të përdoruesve të shërbimeve doganore.

Struktura e të punësuarve gjithsej 1.119 të punësuar



Të punësuar sipas përgatitjes profesionale





IV.1. Trajnime dhe përsosje profesionale

Sistemi i paraparë i trajnimeve është përkufizuar sipas nevojave aktuale dhe të ardhshme të Drejtorisë së doganave si organizatë, por edhe sipas nevojave të të punësuarve. Qëllimi i përsosjes profesionale është që të përmirësoj performancën e punës jo vetëm tek nëpunësit doganor, por edhe tek të punësuarit që janë në vende udhëheqëse dhe që kanë një rol kyç në përmbushjen e qëllimeve të nevojshme, veçanërisht në vendimmarrje që të jenë transparente dhe të mbështesin një zbatim uniform të ligjeve, ndërsa njëkohësisht edhe në proceset e modernizimit dhe zhvillimit të Drejtorisë së doganave që do të zhvillohen me një hap të konsideruar.

Janë realizuar **286** aktivitete për përsosje profesionale për **1.959** nëpunës doganor



Për një të punësuar mesatarisht janë siguruar trajnime me kohëzgjatje prej afro **20 orë dhe 46 minuta**.

Lëndët e trajnimeve që rregullisht janë mbajtur gjatë vitit 2018:

Legjislacioni doganor dhe procedurat doganore

445 nëpunës doganor

Hetime, inteligjencë dhe menaxhim me rrezik

124 nëpunës doganor


Trajnime lidhur me përforsimin e resurseve njerëzore

720 nëpunës doganor


IV.3.Të mësuarit Elektronik

Të mësuarit elektronik paraqet një mjet për rritjen e kapacitetit operaiv në Drejtorinë e doganave dhe pjesë të Axhendës digjitale të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut që duhet kontribuar në rritjen e profesionalizmit dhe kompetencave për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat doganore.

Në ueb faqen e Drejtorisë së doganave mund të gjenden 17 kurse për legjislacionin doganor dhe procedurat doganore (import, eksport, transit). Këto kurse janë destinuar për të gjithë nëpunësit doganor, por edhe për komunitetin e biznesit që të mundësojnë fitimin e njohurive të nevojshme për zbatimin e mirëfilltë të procedurave doganore dhe konstatimin e duhur të vlerës dhe origjinës së mallrave.



“
17 kurse mund të gjenden për legjislacionin doganor dhe procedurat doganore
”




“
Kurset fare lehtë janë të kuptueshme, të paraqitura me dialog të pyetjeve dhe përgjigjeve të thjeshta
”

IV.4 Integriteti

INTEGRITETI = REZISTENCË NDAJ KORRUPCIONIT

Prioriteti më i madh i Drejtorisë së doganave është menaxhimi me korrupsionin, përmes luftës më selektive kundër kriminit. Përmes sistemit për integritet të shërbimit doganor implementohen politikat, standardet dhe procedurat që të përforcojnë rezistencën ndaj korrupsionit dhe të reduktojnë rrezikun ndaj sjelljes korruptive nga ana e të punësuarve.

Hapat e pengimit të korrupsionit dhe përforcimit të integritetit të të punësuarve:





V. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I PROCEDURAVE DOGANORE

V.1. Kushtet për zbatimin e formaliteteve doganore

Drejtoria e doganave gjithnjë punon në avancimin dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese si dhe përfshirjen e mundësive të reja për lehtësim dhe përshpejtim të procedurave doganore si dhe kushteve për zbatimin e tyre, duke përcjellur trendet më të reja të erës digjitale.

V.2. e-Dogana

V.2.1 Sistemi për përpunimin e deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës (SPDDDA)


SPDDDA – REALIZIM I PLOTË I DIGJITALIZIMIT TË PUNËS DOGANORE

Në nëntor të vitit 2018 në Drejtorinë e doganave me sukses është finalizuar zhvillimi i Sistemit për përpunim të deklaratave doganore dhe dokumenteve të akcizës (SPDDDA) i cili tërësisht do të zëvendësoj sistemin ekzistues ASIKUDA. Pas përfundimit të zhvillimit, ekipi i Drejtorisë së doganave vazhdoi me realizimin e Pilot projektit ku janë përfshirë 11 zyra doganore. Lëshimi përfundimtar në përdorim i SPDDDA-së është planifikuar në muajin qershor të vitit 2019.

Me përfshirjen e SPDDDA fillon një erë e re e punës doganore në vendin tonë. Sistemi i ri do të siguroj një zgjidhje të sigurt elektronike në pajtim me standardet e OBT-së dhe BE-së, rrethina pa letër e plotë gjatë zbatimit të procedurave doganore dhe të akcizave përmes shkëmbimit të të dhënave elektronike me operatorët ekonomik dhe institucionet tjera shtetërore, përsheptimi i procedurave doganore dhe atyre të akcizës për operatorët ekonomik dhe kompatibilitet i plotë me sistemet e BE-së.



SPDDA është një sistem kompleks i përbërë nga 10 sisteme - module, 4 nënsisteme dhe më shumë elemente sistemore




PORTALI PËR TREGTARËT – qasje deri tek operatorët ekonomik dhe agjentët doganor deri te SPDDA



Një numër i madh trajnimesh është organizuar për komunitetin e biznesit lidhur me SPDDDA-në, dhe ky aktivitet do të vazhdoj deri në lëshimin përfundimtar në përdorim të sistemit.

SPDDDA paraqet një sistem të integruar që komunikon me sistemet tjera doganore (ITE, EXIM) dhe sistemet e institucioneve tjera.





Komiteti drejtues është pjesë e ekipit për implementimin e SPDDA



V.2.2. EXIM

Sistemi elektronik një sportelesh për lëshimin e patentave të importit dhe eksportit dhe kuotave tarifore –EXIM çdo vit bëhet më i sofistikuar dhe mundëson efikasitet në përshejtimin e procedurave doganore, ndërsa në mënyrë të vazhdueshme rritet edhe numri i përdoruesve të regjistruar.

Lëshimi në funksion i këtij versioni i sistemit EXIM, që paraqet pjesë përbërëse të Sistemit për përpunim të deklaratave dhe dokumenteve të akcizës SPDDDA dhe sistemit për Rrethinë të integruar tarifore (RIT)

Ka hyrë në përdorim edhe funksionimi për operatorët ekonomik: përgatitja paraprake (pre-arrival) (parashtrimi, ndryshimi dhe plotësimi) i kërkesave për patenta në EXIM.

**17 organe shtetërore
të regjistruara**

**60 lloje të ndryshme
të patentave
të importit, eksportit dhe
transitit dhe kuota tarifore**

V.2.3 Deklarata doganore të përpunuara

Gjithsej: 1.063.800 deklaratat doganore (gjatë 2017: 1.020.000), nga të cilat :

- ♣ transit (rreth 45.40%) dhe
- ♣ transit (rreth 29.20%), pas të cilave vijon
- ♣ eksporti (rreth 22.63%) dhe
- ♣ ri-eksporti (rreth 2,77% nga totali i deklaratave të përpunuara).

Pjesëmarrja në procedurat e thjeshtësuara nga totali i procedurave të eksportit dhe importit arrin 24.22%.
Ku, procedurat e thjeshtësuara në eksport marrin pjesë me 42.33%, ndërsa në import 15.20%.

V.3. Operatori i autorizuar ekonomik

Programi për Operatorë të autorizuar ekonomik (OAE) në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një rol të madh në rrethimin e ardhshëm doganor. Avantazhet dhe përfitimet nga ky zbatim Drejtoria e doganave i promovoi në më shumë mbledhje pune të organizuara për njohje të kompanive maqedonase dhe inkurajim shtesë për përfshirjen e tyre në zinxhirin global të furnizimit dhe rritjes së eksportit.



OAE ka një aktivitet kyç që është paraparë në Planin më shumë vjeçar aksionar për integrim rajonal ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe aprovuar në Samitin në Trst. Kompanitë maqedonase inkurajohen që të marrin vendime rreth statusit të Operatorit të autorizuar ekonomik me qëllim që të mund të përfshihen zinxhirët rajonal për furnizim në kuadër të CEFTA-s dhe të përdorin përfitimet dhe avantazet me mundësinë për njohje reciproke të statusit të aprovuar që na paraprin. Një sfidë e madhe për CEFTA-n Sekretariati për aprovimin e rregullave për njohje reciproke të OAE, deri te mbledhja ministrore e CEFTA-s.

Duke përcjellur këtë plan na paraprijnë aktivitete të njëjta për përmbushjen e kushteve për njohje reciproke të aprovimeve.



**DERI MË TANI DY KOMPANI KANË FITUAR STATUSIN OAE, NDËRSA
GJATË VITIT 2019 PRITET QË KU NUMËR TË RRIET DUKSHËM.**



PROMOVHET KONCEPTI PËR OAE NË MË SHUMË SE 300 KOMPANI

ME OAE TREGTIA NDËRKOMBËTARE ËSHTË MË E SIGURT, MË E SHPEJTË, MË EFIKASE


PRIVILEGJE të kompanive maqedonase me status OAE:

- ♣ qasje më e lehtë deri tek procedurat e thjeshtësuara doganore,
- ♣ tretman prioritar gjatë zbatimit të kontrolleve doganore,
- ♣ reduktim i kohës së zhdoganimit të mallrave,
- ♣ reduktim i shpenzimeve për import dhe eksport,
- ♣ numër i reduktuar i kontrolleve fizike dhe atyre të dokumentuara nga organet doganore,
- ♣ zgjedhje e vendit për kontroll dhe privilegje tjera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta,
- ♣ përdorim i logos OAE,
- ♣ gëzojnë privilegje në të gjitha vendet CEFTA (pas nënshkrimit të Marrëveshjeve për njohje të ndërsjellë).



VI. Të hyra të paguara

Të hyrat janë paraqitur në miliona denarë



VII. KONTROLLI DHE ZBATIMI I LIGJEVE

VII.1. KONTROLLI DOGANOR DHE KONTROLLA TJERA

MBROJTJA

Drejtoria e doganave mbron kufijtë shtetëror përmes identifikimit dhe menaxhimit me rreziqe dhe kërcënime. Japim maksimumin tonë që ti përgjigjemi në mënyrë efektive dhe efektive vëllimit të madh të shumëllojshmërisë dhe sofistikimit të kundërvajtjeve doganore dhe atyre financiare.

Baza e punës sonë janë planet strategjike dhe aksionare që paraqesin një tregues rreth asaj se si u qasemi rreziqeve dhe kërcënimeve me të cilat ballafaqohemi. Në esencë mbështetemi në katër parimet kryesore: parandalim, inteligjencë, vendosje efektive e prioriteteve dhe partneritet efikas si dhe bashkëpunim me partnerë të vendit dhe ndërkombëtar.

Viti 2018 ishte vit i sfidave, por edhe shumë produktiv për Doganën.

REZULTATE

Mënyrat e fshehjes së mallit ilegal dhe të ndaluar bëhen gjithnjë e më të ndërlikuar, më inovative dhe më të sofistikuar. Për identifikim dhe zbulim të këtyre rasteve dhe drejtim përkatës i resurseve tona dhe aktiviteteve për parandalimin e tyre, gjithnjë përdorim të dhëna inteligjente dhe informacione nga analiza e rrezikut. Për të pasur një siguri më të madhe kufitare në mënyrë permanente punojmë në përmirësimin e metodologjive dhe aftësive në bazë të analizës së rrezikut. Puna jonë për vitin 2018 ka rezultuar me:



Puna jonë në vitin 2018 rezultoi me:

Zbulohen raste të tregtisë ilegale me droga narkotike, substancia psikotropike dhe prekursorë

Gjatë vitit 2018 Drejtoria e doganave kishte 16 aksione të suksesshme për pengim të kontrabandës së narkotikëve, ku dhe janë sekuestruar mbi 1 ton marihuanë, 9 kg hashash, rreth 3 kg kokainë dhe 15 gramë heroinë. Disa nga rastet më të spikatura janë dhënë më poshtë:



309 kilogramë marihuanë e fshehur në thasë orizi



550 kilogramë drogë e sekuestruar në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë



2 kg kokainë sekuestrohen në Aeroportin e Shkupit



Në Bogorodicë në një bunker special në një automobil zbulohen 35 kg marihuanë dhe 10 kg hashash

Pengohet kontrabandë e trashëgimisë kulturore




98 objekte arkeologjike janë zbuluar në maj të vitit 2018 në pikën e kalimit kufitar Tabanoc

Tentativa të penguara për tregtim të ilaçeve dhe pajisjeve mjekësore

Gjatë vitit 2018 janë penguar 13 tentativa për kontrabandë të 41.786 copëve medikamente dhe pajisje mjekësore. Mes të cilave:

- 34.500 tableta nga bari „Tamol“, zbulohen në Aeroportin ndërkombëtar Shkup, gjenden në bagazhin e një udhëtari;
- 3.580 tableta, 300 lapsa për insulinë, 20 kremra, 60 kapsula, 400 apmula dhe 6 sete ilaçesh, zbulohen në anën e jashtme të kabinës së një kamioni me targa maqedonase, i paraqitur për hyrje në vend në pikën e kalimit kufitar Bogorodice;
- 500 anesteziona, zbulohen gjatë kontrollit për hyrje në vend në pikën e kalimit kufitar Qafëthanë;
- 3.970 instrumente të ndryshme stomatologjike dhe materiale të zbuluara gjatë hyrjes në vend në pikën e kalimit kufitar Bogorodice;



Pengim i bartjes ilegale të parave të gatshme dhe letrave me vlerë

Vitin e kaluar, në pikat e kalimeve kufitare, udhëtarët kanë deklaruar 11.996.059 euro, më shumë në hyrje të vendit. Mesatarisht në muaj janë deklaruar rreth 1 milion euro.

Përpos devizave të deklaruara rregullisht, nëpunësit doganor gjatë vitit 2018 kanë penguar 32 tentativa për bartje ilegale të 308.730 eurove, 31.500 dollarëve amerikan, 32.300 frangave zviceriane dhe 13.000 funtave britanike.



80.000 euro zbulohen në aeroportin ndërkombëtar në Shkup gjatë kontrollit të bagazhit të një shtetasi maqedonas gjatë udhëtimit për në Stamboll.

35.000 euro zbulohen dhe sekuestrohen nga një shtetas grek që ka mbërritur në pikën e kalimit kufitar Tabanoc në maj të vitit 2018.



13.000 funta britanike, zbulohen në Aeroportin ndërkombëtar në Shkup gjatë kontrollit të valixheve të një shtetasi kosovar që ka mbërritur me avion nga Londra.

Zbulohen raste të kontrabandës me cigare dhe prodhime tjera duhani

Gjatë vitit 2018 janë penguar 40 tentativa për kontrabandë me 345.042 copë cigare dhe prodhime tjera duhani. Disa nga sekuestrimet më të mëdha janë:



430 steka cigare në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë – dalje nga vendi, gjatë kontrollit të një kamioni bullgar të zbrazët për transport të automjeteve, në bunkerë të bërë special në tanket për karburant.



155 steka cigare Marlboro pa pulla akcize zbulohen në aeroportin ndërkombëtar në Shkup gjatë kontrollit të bagazhit të një shtetasi të Maqedonisë, që ka pasur për qëllim të udhëtoj për në Londër.



5 kilogram duhan për nargjile dhe 4 kilogram aromë për nargjile zbulohen nga ekipet mobile doganore, gjatë kontrollit të valixheve të një shtetasi të Maqedonisë që ka mbërritur në aeroportin ndërkombëtar në Shkup nga Stambolli.

Pengohen tentativa për kontrabandë të arit, argjendit dhe gurëve të çmuar

Nëpunësit doganor gjatë vitit 2018 kanë zbuluar 6 tentativa për kontrabandë të 9 kg argjendit në granula dhe mbi 2 kg stoli ari. Shumica e rasteve janë zbuluar në aeroportin ndërkombëtar në Shkup.



9 kilogram argjend në granula të vendosura në një kanavacë në çantë janë gjetur gjatë kontrollit të një valixheje të një shtetasi të Maqedonisë që ka mbërritur me fluturim nga Stambolli.



30 copa stoli ari (unaza, byzylykë, zinxhirë, vathë dhe medalje) në masë totale prej 230 gramëve, 1 pare ari prej 8 gramëve janë gjetur gjatë kontrollit të bagazhit dhe kontrollit personal të një shtetasi të shqiptar që ka udhëtuar nga Stokholmi.



973 gurë të çmuar janë gjetur në xhepat e një shtetasi turk që ka udhëtuar nga Stambolli në aeroportin ndërkombëtar Shkup



Një sasi më e madhe e stolive nga ari i bardhë kombinuar me një numër të madh brilantesh që sipas kontrollit të bërë është me vlerë prej rreth 450 mijë eurove, gjenden gjatë kontrollit të bagazhit të një shtetaseje turke që ka mbërritur nga Stambolli.



10 byzylykë prej arit 22 karat (276 gram) zbulohen gjatë kontrollit të një autobusi maqedonas që ka qarkulluar në relacionin Stamboll – Ohër dhe ka mbërritur në hyrje të vendit në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë. Byzylykët e padeklaruar janë gjetur të mbështjellë në çorape, në një çantë dore të shtetases australiane me origjinë maqedonase që ka udhëtuar në autobus.

Pengohen raste të kontrabandës së ushqimit dhe pijeve

- ♣ Gjatë vitit 2018, nëpunësit doganor kanë penguar tentativa të kontrabandës së 735 shisheve të alkoolit dhe 4.565 kilogramëve dhe 109.411 copë produkte ushqimore.
- ♣ 4.200 kilogram mish pule i ngrirë zbulohet nga ekipet mobile doganore gjatë kontrollit të një kamioni nga Maqedonia drejtuar nga një shtetas maqedonas gjatë daljes nga vendi në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë.
- ♣ 240 litra raki shtëpie dhe 30 litra verë shtëpie zbulohen nga ana e ekipeve mobile doganore.
- ♣ 30,6 kilogram krap Ohri dhe 10 rrjeta peshkimi nga 100 metra



Zbulohen raste të kontrabandës së mallit luksoz

- ♣ Gjatë vitit 2018 janë penguar tentativa për kontrabandë të rreth 500 copë malli luksoz: veshje, aksesore mode, kozmetikë.
- ♣ 155 parfume nga 50 ml dhe 12 sete deodorant dhe parfum, zbulohen në aeroportin ndërkombëtar Shkup gjatë kontrollit të bagazhit të një shtetasi maqedonas që ka mbërritur nga Stambolli.
- ♣ 132 copë orë dore, 112 copë syze dielli, 25 copë rripa dhe 18 copë kuleta, malli i padeklaruar është fshehur në pjesën e gomës rezervë.
- ♣ 43 parfume dhe ujë kolonje, 16 fustane, 23 palë këpucë, 3 rripa meshkujsh dhe 1 palë syze dielli zbulohen në dy raste të ndara në aeroportin ndërkombëtar në Shkup, gjatë kontrollit të valixheve të dy shtetasve maqedonas të paraqitur për hyrje në vend.
- ♣ 1 orë dore ROLEX zbulohet në bagazhin e një shtetasi gjerman me origjinë nga Republika e Maqedonisë së Veriut që ka mbërritur nga Beogradi.
- ♣ 40 pallto femrash zbulohen gjatë kontrollit të një automjeti rumun me të cilin gjatë hyrjes në vend në pikën e kalimit kufitar Bogorodicë janë paraqitur dy shtetas rumun.

Pengohen tentativa për kontrabandë të armëve

- ♣ 4 pushkë air soft, 2 armë pa zë dhe 3 diabola për to zbulohen gjatë kontrollit të një automjeti të Maqedonisë i paraqitur për hyrje në pikën e kalimit kufitar Tabanoc autostradë. Armët e padeklaruara dhe municioni janë gjetur në një kuti të fshehur në gomën rezervë.
- ♣ 1 pistoletë me gaz EKOL Aras Magnum me kalibër 9 mm dhe 50 copë municion për pistoletë gazi i markës IRON kalibri 9 mm P.A.K.

VII.2. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale

Në 58 aksione gjatë vitit 2018 përkohësisht janë mbajtur 175.750 copë dhe 2.506 kilogramë mall nga dyshimi për cenim të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Në bazë të cenimit të konstatuar të të drejtave nga pronësia intelektuale, nën vëzhgim doganor janë asgjësuar 85.712 copë produkte të falsifikuara (shampo, mburoja për telefona celular, loja, tuta, shapka, çorape, veshje për fëmijë etj.).

VII.3. LABORATORI DOGANOR



Gjatë vitit 2018 është prokuruar **pajisje e re për Laboratorin doganor** nga fondi evropian (IPA projekti) dhe nga mjetet buxhetore. Pajisja është destinuar për analizë të mallit të akcizës (alkool dhe produkte alkooli, naftë dhe derivate të naftës), produkte të industrisë kimike dhe mallra tjera që kontrollohen nga aspekti i detyrimeve të shmangura ose u nënshtrohen ndalesave dhe kufizimeve. Pajisja është parakusht për akreditim sipas standardit ISO 17025.



Në kuadër të twining projektit "Përforcimi i kapaciteteve operative dhe institucionale në Drejtorinë e doganave" janë zhvilluar tri metoda laboratorike:

- Metoda për përcaktim të përmbajtjes së sulfurit në derivatet e naftës,
- Përcaktimi i përmbajtjes së FAME në biodizel dhe
- Kjeldahl-metoda për përcaktimin e proteinave në produktet ushqimore.

Validiteti i metodave të reja është në proces e sipër.

VII.4. Padi penale

Janë parashtruar 44 padi penale kundër 55 personave fizik dhe 15 personave juridik

Struktura e veprave penale është e shumëllojshme, ndërsa më së shpeshti bëhet fjalë për kontrabandim (17 raste), prodhim i paautorizuar dhe qarkullim i narkotikëve (8 raste), falsifikim dokumentesh (8 raste) cenim i të drejtave nga pronësia intelektuale (7 raste), mashtrim tatimor (1 rast) etj.

Kundërvajtje doganore, me deviza dhe akciza

Gjatë vitit 2018:

Janë parashtruar
681 padi për
kundërvajtje

(638 për kundërvajtje doganore, 29 për kundërvajtje me deviza dhe 14 për kundërvajtje me akciza). Nga totali i padive të parashtruara 409 u referohen personave fizik dhe 272 personave juridik.

Janë zgjidhur 507
lëndë
kundërvajtëse

ku dhe kryerësve u është shqiptuar gjobë në shumë prej rreth 34 milion denarë.

Janë shqiptuar
1.953 dënime
mandati

kundër 1.104 personave fizik dhe 849 personave juridik, ku kryerësve u janë shqiptuar dënime në shumë prej rreth 73 milion denarëve.

VII.5. PJESËMARRJE NË OPERACIONE NDËRKOMBËTARE

Drejtoria e doganave mori pjesë në 12 operacione ndërkombëtare të organizuara nga Organizata botërore doganore, Europoli, Interpoli, Fronteksi, Zyrat rajonale të inteligjencës për lidhje (RILO AP, RILO ECE), SELEC etj.

Në kuadër të bashkëpunimit të vendosur me organizatat ndërkombëtare për zbatimin e ligjit Drejtoria e doganave në bazën e të dhënave ka futur 59 sekuestime, ka dorëzuar 60 informacione rreth mallit të sekuestruar deri tek qendra SELEC, 13 informacione për sekuestrim të drogës deri tek ZKA Balkan info dhe 4 informacione për sekuestrim deri te „Containercom“ sistemi i komunikimit i OBD-së.

VIII. TRANSPARENCË DHE BASHKËPUNIM NË FUSHËN E DOGANAVE

VIII.1. Marrëdhënie me publikun

Drejtoria e doganave në mënyrë të vazhdueshme avancoi transparencën si një nga mënyrat më të mira për pengim të korrupsionit por edhe ndërton marrëdhënie të mira me grupet e interesit dhe krijon publicitet të favorshëm me publikun.

VIII.1.1. Ngjarje më të spikatura



Me rastin e 26 janarit – Ditës ndërkombëtare të Doganës, që në vitin 2018 u shënua nën moton “Rrethim i sigurt afarist për zhvillim ekonomik”, drejtori i Drejtorisë së doganave, katër nëpunësve doganor u ndau mirënjohje nga Kuniu Mukurija, Sekretar gjeneral i OBD-së.

Drejtorja e doganave në vitin 2013 mori certifikatën ISO 9001:2008 për menaxhim me cilësi. Vendosja e cilësisë, përdoruesve dhe klientëve gjatë viteve solli që proceset dhe procedurat të rezultojnë me marrjen e standardit ndërkombëtar ISO 9001:2015.



Më datë 14 prill – Dita e Doganës, Drejtorja e doganave shënoi 26 vite nga ekzistimi i saj si organ i mëvetësishëm. Me këtë rast, më datë 11 prill 2018 në Muzeun e artit bashkëkohor në Shkup është mbajtur një ceremoni solemne ku kanë marrë pjesë përfaqësues të vendit, qeverisë, ministrive, korit diplomatik, përfaqësues të shkencës dhe komunitetit të biznesit, Kolegji i Drejtorisë së doganave dhe bashkëpunëtor tjerë si dhe miq të Drejtorisë së doganave.



Me rastin e shënimit të 14 prillit – Ditës së Drejtorisë së doganave janë organizuar tri fushata: “Stop produkteve të falsifikuara”, “Denonco korrupsionin” dhe “Mos u bëj mushkë” me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve në luftën kundër falsifikimeve, korrupsionit dhe pasojave të dëmshme nga tregtimi me drogë.

Drejtorja e doganave e Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Entin Republikan për transfuziologji gjatë vitit 2018 ka realizuar aksionin tradicional të dhurimit të gjakut në kuadër të programit për përgjegjësi shoqërore gjatë shënimit të Festës së doganës.



Më datë 30 maj 2018 është lëshuar në përdorim terminali i ri doganor në pikën e kalimit kufitar Tabanoc. Rindërtimi i terminalit, financuar nga Bashkimi Evropian mundësoi lehtësim të tregtimit ndërkuftar përgjatë Korridorit 10 dhe zbatim të procedurave doganore me kapacitete moderne.

VIII.1.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi me Programin për kontroll të eksportit dhe sigurisë kufitare pranë Ambasadës së SHBA-ve

Gjatë vitit 2018 në më shumë raste, Programi për kontroll të eksportit dhe sigurisë kufitare (EXBS) e Qeverisë së SHBA-ve siguroi ndihmë dhe mbështetje për punën gjithpërfshirëse doganore përmes donacionit të pajisjeve operative si dhe trajnimeve të specializuara për përgatitje profesionale të nëpunësve doganor.

- ♣ Më datë 12 shkurt janë dhënë donacione pajisje me vlerë prej rreth 18 mijë dollar amerikan (sistem për kontrol me videoskop, instrumente për matjen e dendësisë dhe vegla dore).
- ♣ Gjatë periudhës nga data 26 deri më datë 28 shkurt 2018 është mbajtur Trajnim për përforsimin e shkathtësive për monitorim të sjelljes (opservacion bihejviorist) destinuar për 24 nëpunës doganor dhe nëpunës policor.
- ♣ Në periudhën mes datës 26 dhe 27 mars 2018 nëpunësit doganor kishin nderin që të mbajnë trajnim për manovrim të pajisjeve specifike për kolegët e Administratës doganore të Kosovës. Për punën e tyre trajnuesit janë shpërblyer me mirënjohje dhe rang nga Programi për kontroll të eksportit dhe sigurisë kufitare.
- ♣ Më datë 29 maj 2018 është lëshuar në përdorim një sistem i ri për zbulimin e narkotikëve dhe eksplozivëve. Përpos donacionit Programi ka siguruar edhe trajnim për operatorët e sistemit për 10 nëpunës doganor të Maqedonisë.
- ♣ Më datë 13 dhjetor 2018 në Ministrinë e punëve të brendshme në mënyrë solemne është dorëzuar donacioni i pajisjeve dhe automjeteve. Donacioni me vlerë 500.000 dollarë përbëhet nga 2 furgonë special me pajisje mobile për zbulim dhe rrezatim.

VIII.2.2. Takime bilaterale

- ♣ Më datë 5 prill 2018 në Korçë është mbajtur takim bilateral mes delegacioneve të Drejtorive të doganave të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë. Takimi i delegacioneve paraprirë nga drejtorët e të dy administratave është mbajtur në drejtim të përforcimit dhe bashkëpunimit mes të dy vendeve.
- ♣ Delegacioni i Drejtorisë së doganave paraprirë nga drejtori më datë 4 dhe 5 qershor 2018 ka realizuar vizitë pune në Drejtorinë e doganave të Republikës së Kroacisë.



Takim joformal rajonal i drejtorëve të drejtorive të doganave të Ballkanit Perëndimor.

Nga data 11 deri më 12 qershor 2018 drejtori i Drejtorisë së doganave mori pjesë në një Takim rajonal joformal të drejtorëve të drejtorive të doganave të Ballkanit Perëndimor, që është mbajtur në Republikën e Shqipërisë.



Projekti për menaxhim të përbashkët kufitar mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Serbisë

Më datë 2 shtator 2018, në pikën e kalimit kufitar Tabanoc-Preshevë nga ana e z. Zoran Zaev, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Aleksandar Vuçiq, president i Republikës së Serbisë, është paralajmëruar fillimi i implementimit të Projektit për menaxhim të përbashkët kufitar „One Stop Shop“ mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Serbisë.



„One stop shop“ është konfirmim më i madh për punën e përkushtuar në këtë projekt, që Drejtorja e doganave e kishte pikësynim si një nga qëllimet më të rëndësishme strategjike.

Drejtoria e doganave nikoqir në Takimin e katërt në Grupin e punës për bashkëpunim në lehtësimin e zhdoganimit mes Kinës, Hungarisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut

Në periudhën mes 5 dhe 6 shtatorit të vitit 2018, drejtoria e doganave e Republikës së Maqedonisë së Veriut udhëhoqi Takimin e katërt të Grupit të punës për implementimin e Marrëveshjes kornizë për bashkëpunim në lehtësimin e zhdoganimit mes Drejtorive të doganave të Kinës, Hungarisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut.



VIII.3.2. Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit

Në drejtim të përforcimit të bashkëpunimit me të gjithë operatorët ekonomik, por edhe lehtësimin e procedurave doganore, në vitin 2018 janë mbajtur më shumë takime pune me të gjitha palët pjesëmarrëse në procedurat doganore:

- 3 takime me Trupin këshilldhënës ku do të shqyrtohen më shumë çështje aktuale nga fusha e punës doganore, si dhe kërkesat e komunitetit të biznesit.
- Më datë 27 shkurt 2018 është mbajtur takim pune me përfaqësues të Odës ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore. Në takim është diskutuar rreth sfidave ku pjesëtarët e Odës ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore ballafaqohen me procedura të përditshme doganore.

- ♣ Më datë 30 mars 2018 është mbajtur takim pune me prodhuesit dhe importuesit e pijeve alkoolike, me qëllim të njohjes me dispozitat e propozimit Ligjit të ri për akcizat. Në takim kompanitë u njohën me dispozitat që propozohen me propozim Ligjin e ri për akcizat.
- ♣ Më datë 10 tetor 2018 në Drejtorinë e doganave është mbajtur takim – dita e hapur me pjesëmarrësit në procedurën doganore (importues, eksportues, përfaqësues, agjent doganor, prodhues dhe transportues). Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit është faktor kyç për ndërtimin e besimit, promovim të qeverisjes së mirë dhe përsheptim dhe thjeshtësim të procedurave doganore.
- ♣ Më datë 16 tetor 2018 në Shkup, Drejtoria e doganave e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Oda ekonomike maqedono – turke (MATTO) është mbajtur takim pune ku janë prezantuar tema aktuale dhe risi nga fusha e punës doganore.

VIII.3.3 Promovim i konceptit Operator i autorizuar ekonomik


Në drejtim të ndërtimit të raporteve të partneritetit mes bartësve të politikave – Qeverisë, Ministrisë së financave, Drejtorisë së doganave dhe përfaqësuesve të sektorit privat që marrin pjesë në promovimin e konceptit Operator i autorizuar ekonomik. Mbledhjet e punës në organizim të Drejtorisë së doganave duke bashkëpunuar me Projektin e USAID për rritje ekonomike rajonale që është mbajtur në Shkup, Strumicë dhe Ohër.

Drejtoria e doganave partneritetin me komunitetin afarist e realizon përmes punës së Trupit këshilldhënës, ku përveç Drejtorisë së doganave marrin pjesë Oda ekonomike e Republikës së Maqedonisë, Lidhja e odave ekonomike e Republikës së Maqedonisë, Oda ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore, Oda amerikane ekonomike në Republikën e Maqedonisë, SIZ "Trafiku Maqedonia" AMERIT, Grupacioni i agjentëve doganor dhe operatorëve logjistik – MIFA, Shoqata tregtare e tekstilit – Grupi I tekstilit, Oda ekonomike për teknologji informacioni dhe komunikimi – MASIT, Oda ekonomike holandeze, Oda ekonomike Maqedonase Bullgare, Bashkimi i odave ekonomike gjermane për industri dhe trakti – Përfaqësia Shkup, Oda ekonomike e Maqedonisë – Turqia dhe Shoqata për industri përpunimi të lëkurës.

VIII.3.4. Nënshkruhet Memorandum për bashkëpunim


- Më datë 19 prill 2018 drejtori i Drejtorisë së doganave dhe rektori i Universitetit “Goce Dellçev” – Shtip kanë nënshkruar Memorandum për bashkëpunim. Inkorporimi i mendimit profesional dhe shkencor gjatë përkufizimit dhe zbatimit të politikave të Drejtorisë së doganave, paraqet një segment të rëndësishëm nga bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë. Në këtë mënyrë sigurohet zbatimi i politikave ekonomike dhe lehtësimit të tregtisë.
- Më datë 16 maj 2018 është nënshkruar Memorandum për bashkëpunim me shoqërinë TDR Shkup SHPKNJP Shkup si anëtar i grupacionit „British American Tobacco“. Me këtë Memorandum rregullohet procedura mes kompetencave të palëve me qëllim të luftës kundër kontrabandës dhe tregtisë ilegale me prodhime duhani dhe mbrojtjes nga cenimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, respektivisht pengimit të falsifikimit të cigareve dhe produkteve tjera të duhanit nga markat tregtare bartësit e të cilave janë kompani anëtare të grupacionit „British American Tobacco“.
- Më datë 25 korrik 2018 janë nënshkruar memorandume për bashkëpunim me Asociacionin për e-Tregti të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe “DHL Express Maqedonia“. Memorandumet për bashkëpunim paraqesin konfirmim se Drejtoria e doganave udhëhiqet nga parimet e përbashkëta të vendosjes dhe veprimit, kuptimit të partnerëve. Duke marrë parasysh avantazhet dhe rrjedhat bashkëkohore të tregtisë elektronike që përfshin të gjitha transaksionet e realizuara nga largësia, me përdorim të platformave elektronike ose digjitale.
- Drejtori i Drejtorisë së doganave dhe drejtorit të Byrosë për siguri publike, më datë 14 maj nënshkruan Protokoll për rregullimin e procedurave për rrjedhë më të shpejtë të mallit të gjallë, mallit në gjendje të gjallë, materieve të rrezikshme, mallit në sistemin e ri të kompjuterizuar të transitit dhe kamionëve të zbrazur në pikat e kalimeve kufitare Tabanoc dhe Bogorodicë. Ky protokoll është jashtëzakonisht domethënës për bujqësinë maqedonase – produktet ushqimore.

VIII.4. Internet



Gjatë vitit 2018 në faqen e internetit të Drejtorisë së doganave janë publikuar gjithsej 392 përmbajtje në gjuhën maqedonase, shqipe dhe atë angleze. Në periudhën janar – dhjetor faqja është vizituar 1.000.195 herë, ndërsa më të vizituara janë rubrikat: “Lajme” (236.217 vizita), “Tarifa doganore” (21.583 vizita), “Sistemi i ri i kompjuterizuar i transitit – NCTS” (21.060 vizita) dhe “Kontakte” (8.332 vizita).

VIII.5. Linja e hapur telefonike e doganës (197)



Në linjën e hapur telefonike të doganës (197) gjatë vitit 2018 janë pranuar gjithsej 5.924 thirrje ose mesatarisht 16 thirrje në ditë edhe atë: të klasit „A” – 17 thirrje, të klasit „B” – 18 thirrje, të klasit „C” – 365 thirrje dhe të klasit „J” – 32 thirrje. Numri më i madh u referohet thirrjeve lidhur me funksionimin dhe gjendjen e zyrave doganore kufitare dhe atyre të brendshme, si dhe zbatimit të procedurave individuale doganore.

Klasa “A” janë informacione që kërkojnë aksion të menjëhershëm nga ana e zyrës doganore dhe ekipit mobil.

Klasa “B” janë informacione që kërkojnë ekzaminime të mëtejshme shtesë dhe ekzaminime nga seksione tjera në Sektorin për kontrollë dhe hetime dhe seksione tjera në Drejtorinë e doganave.

Klasa “C” janë informacione që nuk mund të përdoren, respektivisht thirrje për paraqitje të ngecjeve nga ana e kompanive transportuese, ankesa ose lëndrata të procedurave doganore.

Klasa “J” se informacione të përcjella nga Sektorin për standarde profesionale ndërsa u referohen ankesave të qytetarëve për sjellje korruptive dhe punë profesionale të nëpunësve doganor.







BOTUES:

DREJTORIA E DOGANAVE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
LAZAR LIÇENOSKI 13, 1000 SHKUP

WWW.CUSTOMS.GOV.MK

DIZAJNI:

ANDREA SHIMBOV

SHTYPI:

PRO GRAFIKA

TIRAZHI:

50